



UNIVERSITETI I MITROVICËS
UNIVERSITY OF MITROVICA
“ISA BOLETINI”

PIM Trepça, 40 000 Mitrovicë, Republika e Kosovës
Tel: +381-28535725, [URL:http://www.umib.net](http://www.umib.net), Mail:rektorati@umib.net

RAPORT I TË HYRAVE DHE SHPENZIMEVE
PËR PERIUDHËN JANAR/SHTATOR - 2018

Tetor/2018

P Ë R M B A T J A

| | |
|--|----|
| 1. Hyrja..... | 3 |
| 2. Analiza e Buxhetit..... | 6 |
| 3. Pasqyra e realizimit të buxhetit e strukturuar sipas kategorive ekonomike | 7 |
| 4. Shpalosja e pasqyrave të shpenzimeve të strukturuar nëpër kategori ekonomike... | 8 |
| 4.1 Paga dhe mëditje | 8 |
| 4.2 Mallra dhe shërbime..... | 11 |
| 4.3 Shpenzime komunale..... | 16 |
| 4.4 Subvencione dhe transfere..... | 16 |
| 4.5 Investime kapitale..... | 17 |
| 5. Të hyrat vetanake..... | 18 |

1. HYRJE

Bazuar në Ligjin mbi Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë Nr.03/L-048, neni 45 pika 45.2 lidhur me raportet tremujore buxhetore, Statutin e Përkohshëm të Universitetit të Mitrovicës neni 28 pika 1.9 dhe 1.10 mbi detyrat dhe përgjegjësitë e rektorit, neni 180 lidhur me procedurat buxhetore, rektori në bashkëveprim me menaxhmentin e Universitetit të Mitrovicës hartoi raportin mbi planifikimin dhe realizimin e të hyrave dhe shpenzimeve për periudhën janar-shtator të vitit fiskal 2018.

Raporti përmban një analizë përmbledhëse të performancës së aktiviteteve të cilat ndërlidhen me objektivat e planifikuara sipas Kornizës Afatmesme të Shpenzimeve 2018/2020, vendimeve nga niveli qendror(MF,MASHT), rekomandimeve të Këshillit Drejtues dhe menaxhmentit lidhur me përcaktimin e prioriteteve të kushtëzuara në mungesë të burimeve financiare.

Buxhetin e Universitetit të Mitrovicës e karakterizon procesi i konsultimeve dhe sistemimi i të gjitha kërkesave të administratës qendrore dhe njësive akademike të harmonizuar me kufijtë final të përcaktuar nga Ministria e Financave. Kërkesat janë të harmonizuar me njësitë akademike duke konsideruar që aktivitetet të ndërlidhen me implementimin e përgjegjësiqe që janë përcaktuar me fushëveprimin e institucionit të Arsimit të Lartë në Kosovë.

Raporti, përmes pasqyrave financiare, pasqyron se në ç'mënyrë institucioni i Universitetit të Mitrovicës bazuar në Ligjin mbi Ndarjen Buxhetore për vitin 2018, administroi: burimet financiare dhe shpenzimet

Pasqyrat financiare për periudhën raportuese janë të bazuara në dokumentet:

1. Ligji mbi Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë-pasqyrimi i pasqyrave financiare.
2. Korniza Afatmesme e Shpenzimeve 2018-2020.
3. Ligji mbi Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2018.
4. Statuti i përkohshëm për UMIB.
5. Buxheti për vitin 2018 për UMIB
6. Rregulloren mbi të ardhurat personale për UMIB
7. Vendimeve të aprovuara nga Këshilli Drejtues mbi ndarjet,aprovimet financiare
8. Planin e rrjedhës së parasë të bazuar në Ligjin mbi Ndarjen Buxhetore për vitin 2018


Pasqyrat financiare janë të harmonizuara me të dhënat e sistemuara në Sistemin Informativ të Menaxhimit të Financave të Kosovës(SIMFK).

Buxheti për Universitetin e Mitrovicës i bazuar në Ligjin për Buxhetin të Republikës së Kosovës nr.06-L-20

Buxheti për UMIB i aprovuar në Janar/2018 konform Ligjit për Buxhetin e Republikës së Kosovës nr.06/L-20 ishte 2.905.398.00 euro që në krahasim me buxhetin e vitit 2017 është më i lartë për 86.700.00 euro ose me indeks prej 3.07%.

| | KATEGORIA EKONOMIKE | Buxheti i aprovuar në janar sipas Ligjit mbi ndarjen buxhetore për vitin 2018 |
|----|---------------------|---|
| | 1 | 2 |
| 1. | PAGA DHE MËDITJE | 2.042.359.00 |
| 2. | MALLRA DHE SHËRBIME | 316.339.00 |
| 3. | SHPENZIME KOMUNALE | 215.000.00 |
| 4. | SUBVENCIONE | 30.000.00 |
| 5. | INVESTIME KAPITALE | 301.500.00 |
| 6. | GJITHSEJ | 2.905.398.00 |

Buxheti i aprovuar në janar sipas Ligjit mbi ndarjen buxhetore për vitin 2018



Buxheti i strukturuar sipas kategorive ekonomike dhe burimeve të financimit

| | KATEGORIA EKONOMIKE | Buxheti i aprovuar sipas Ligjit mbi buxhetin për 2018 | Burimet e financimit | |
|----|---------------------|---|----------------------|-------------------|
| | | | Buxheti i Kosovës | Të hyrat vetanake |
| 1. | PAGA DHE MËDITJE | 2.042.359.00 | 1.927.68.00 | 114.661.00 |
| 2. | MALLRA DHE SHËRBIME | 316.339.00 | 316.339.00 | |
| 3. | SHPENZIME KOMUNALE | 215.000.00 | 215.000.00 | |
| 4. | SUBVENCIONE | 30.000.00 | 30.000.00 | |
| 5. | INVESTIME KAPITALE | 301.500.00 | 301.500.00 | |
| 6. | GJITHSEJ | 2.905.398.00 | 2.790.737.00 | 114.661.00 |


Paga dhe mëditje- për vitin fiskal 2018 masa buxhetore e planifikuar për përmbushjen e obligimeve për paga është 2.042.359.0 euro që është për 199.999.56 më e lartë se paga e planifikuar për vitin fiskal 2017. Indeksi i rritjes është për 10.85% kurse pjesëmarrja e buxhetit për paga dhe mëditje në strukturë është 70.29% të buxhetit të aprovuar.

Mallra dhe shërbime - Masa buxhetore për këtë kategori është 316.339.00 dhe nuk ka pësuar ndryshime, pjesëmarrja në buxhet total është 10.88%

Shpenzime Komunale- shpenzimet komunale janë 215.000.00 dhe janë më të larta për 165.000.00 euro ose me indeks prej 430%, pjesëmarrja prej 7.40% në buxhetin e aprovuar.

Subvencionet- mjetet e planifikuara janë në shumë prej 30.000.00 euro dhe janë më të larta për 20.000.00 euro ose me indeks prej 300% me pjesëmarrje 1.32% në strukturën e buxhetit të ndryshuar.

Investime kapitale- Investimet kapitale për këtë vit fiskal janë planifikuar me shumë prej 301.500.00 dhe janë më të ulëta për 298.500.00 euro ose me indeks prej 50.25 më të ulëta në krahasim me planifikimi e viti 2017.



2. ANALIZA E BUXHETIT

Buxheti i strukturuar nëpër kategori ekonomike i bazuar në kufijtë final të aprovuar nga Kuvendi i Kosovës për Universitetin e Mitrovicës pasqyron mundësinë e realizimit të aktiviteteve të cilat ndërlidhen me fushëveprimin e Universiteteve publike.

Kufijtë final të strukturuar nëpër kategori ekonomike në masë të madhe në aspektin financiar nuk ndërlidhen me objektivat dhe aktivitetet e planifikuara të pasqyruara në Kornizën Afatmesme të Shpenzimeve për vitet 2018/2020 . Buxheti dhe mungesa e mjeteve obligoi Këshillin Drejtues, përmes Rektorit të përcakton prioritete të reja duke strukturuar shpenzimet të cilat ishin mase të domosdoshme për funksionalizim të universitetit për të përmbushur misionin dhe realizimin e vizionit .


Buxheti për UMIB-in i aprovuar në Janar/2018 konform Ligjit për Buxhetin e Republikës së Kosovës nr.06/L-020 ishte 2.905.398.00 që në krahasim me buxhetin e vitit 2017 është më i lartë për 86.700.00 euro ose me indeks prej 3.07%.

Për periudhën raportuese (janar-shtator) janë alokuar mjete në shumë prej 2.518.748.10 euro ose 86.69% të buxhetit të aprovuar. Alokimi i mjeteve është bërë sipas planit të rrjedhës së parasë të hartuar sipas strukturimit të kërkesave dhe planifikimit të aktiviteteve për administratën qendrore dhe të njësive akademike.

Realizimi i buxhetit për të njëjtën periudhë është me indeks prej 82.64% (2.081.558.15 euro) bazuar në alokimin e mjeteve (2.518.748.10) ose me indeks prej 71.64% në krahasim me buxhetin e aprovuar (2.905.398.00 euro). Mjetet e angazhuara për këtë periudhë janë në shumë prej 2.318.607.71 euro ose 86.05% të mjeteve të alokuara.

Indeksi i realizimit për vitin 2018 është më i lartë për 6.14% në krahasim me indeksin e realizimit për periudhën e njëjtë të vitit 2017 ku indeksi ishte 76.50%

| Nr. | PERIUDHA E REALIZIMI | MJETET E REALIZUARA | INDEKSI I REALIZIMIT |
|-----|----------------------|---------------------|----------------------|
| | | 2 | 3 |
| 1. | JANAR/SHTATOR /2017 | 1.959.873.79 | 76.50% |
| 1. | JANAR/SHTATOR/2018 | 2.081.558.15 | 82.64% |



Periudha janar/shtator karakterizohet për racionalizim të shpenzimeve duke përcaktuar edhe prioritetet që ndërlihen me realizimin e kërkesave të njësive akademike. Vëmendje e posaçme ju kushtua racionalizimit të shpenzimeve me qëllim që mjetet e kursyera të orientohen në organizimin e inaugurimit të Kampusit universitar si dhe mjeteve/pajisje që do të jenë në proces të mirëmbajtjes së procesit të funksionimit të laboratorëve të njësive akademike.

Zyra për buxhet dhe financa bartëse e procesit dhe mbikëqyrjes së realizimit është përqendruar që kërkesat të jenë të harmonizuara me planifikimin e shpenzimeve të bazuar në planin e rrjedhës së parasë së gatshme për të njëjtën periudhë.


3. Pasqyra e realizimit të buxhetit e strukturuar sipas kategorive ekonomike

Zyra për buxhet dhe financa bartëse e procesit të ekzekutimit dhe mbikëqyrjes së buxhetit përmes pasqyrave financiare pasqyron si është bërë menaxhimi i parasë publike duke analizuar dhe bërë krahasime me planifikim, burimet dhe realizim të mjeteve të strukturuar nëpër kategori ekonomike.

Për periudhën raportuese (janar-shtator) janë alokuar mjete në shumë prej 2.518.748.10 euro ose 86.69% të buxhetit të aprovuar. Realizimi i buxhetit është me indeks prej 82.64 % (2.081.558.15) bazuar në alokimin e mjeteve.

Në tabelën e poshtëshënuar është pasqyruar realizimi i buxhetit i krahasuar me burime, alokime, zotime, realizim dhe indeks të realizimit

| Kategoritë ekonomike | Buxheti i planifikuar bazuar në Ligjin mbi buxhetin 2018 | Alokimi Janar/shtator | Mjetet e shpenzuara Janar/shtator | Zotimet/ obligimet e pa shlyera | Shpenzimet e planifikuara | Mjetet e pashfrytëzuara | Mjetet e angazhuara në % | Shpenzimi i buxhetit në % |
|----------------------|--|-----------------------|-----------------------------------|---------------------------------|---------------------------|-------------------------|--------------------------|---------------------------|
| | 1 | 2 | 3 | 4 | 5=3+4 | 6=2-5 | 7=5/2*100 | 8=3/2*100 |
| Paga & Mëditje | 2.042.359.00 | 1.765.346.63 | 1.765.346.63 | | 1.765.346.63 | | 100 | 100 |
| Mallra&Shërbime | 316.339.00 | 276.286.79 | 162.064.68 | 21.014.58 | 183.079.26 | 93.207.53 | 66.26 | 58.66 |
| Shpenzime komunale | 215.000.00 | 145.614.68 | 38.681.82 | | 38.681.82 | 106.932.86 | 26.56 | 26.56 |
| Subvencione | 30.000.00 | 30.000.00 | 29.999.75 | 0.25 | 30.000.00 | | 100 | 100 |
| Kapitalet | 301.500.00 | 301.500.00 | 85.465.27 | 216.034.73 | 301.500.00 | | 100 | 28.34 |
| Total | 2.905.398.00 | 2.518.748.10 | 2.081.558.15 | 237.049.56 | 2.318.607.71 | 200.140.49 | 92.05 | 82.64 |



Pagat dhe mëditjet - janë alokuar 1.765.346.63 euro për përmbushjen e obligimeve për paga për personelit akademik të rregullt, të angazhuar dhe personelin administrativ. Për periudhën raportuese janë realizuar 1.765.346.63 euro ose me indeks të realizimit prej 100% përkatësisht janë shpenzuar mjete me indeks prej 86.43% të mjeteve të planifikuara (2.042.359.00 euro) sipas buxhetit të aprovuar.

Mallrat dhe shërbimet janë alokuar 276.286.79 euro ose me indeks prej 87.33% të mjeteve të planifikuara sipas buxhetit të aprovuar. Mjetet e alokuara janë realizuar në shumë prej 162.064.68 euro ose me indeks prej 58.66 % në krahasim me mjetet e alokuara.

Shpenzimet komunale janë alokuar 145.614.68 dhe janë realizuar 38.681.82 ose me indeks prej 26.56% në krahasim me mjetet e alokuara

Subvencionet dhe transferet –janë realizuar 29.999.75 euro ose me indeks prej 100% në krahasim me mjetet e alokuara.

Investimet kapitale -sipas planit të rrjedhës së parasë janë alokuar 301.500.00 mjetet për investime kapitale,mjetet janë realizuar në shumë prej 85.465.27 euro ose me indeks prej 28.34% në krahasim me mjetet e alokuara.

4. Shpalosja e pasqyrave të shpenzimeve të strukturuar nëpër kategori ekonomike duke bërë krahasime me indeksin e realizimit dhe shumën e mjeteve të pashfrytëzuara-kursyera

4.1 PAGA DHE MËDITJE

Buxheti i aprovuar sipas Ligjit mbi Ndarjen Buxhetore për kategorinë ekonomike paga dhe mëditje është 2.042.359.00 euro i planifikuar për përmbushjen e obligimeve ndaj 196 punëtorëve (129 personel akademik dhe 67 personel administrativ) . Bazuar në strukturën organizative,numrin e planifikuar dhe rregulloren mbi të ardhurat personale të aprovuar nga Këshilli Drejtues i Universitetit të Mitrovicës masa e planifikuar buxhetore nuk është e mjaftuar për të realizuar obligimet ndaj të punësuarve në UMIB. Buxheti mbulon vetëm pagat e 139 të punësuarve(personel akademik të rregullt,të angazhuar dhe administrativ) në UMIB duke pamundësuar edhe rekrutimin e 57 pozitave që parashihen sipas strukturës së aprovuar organizative dhe numrit të lejuar sipas Ligjit mbi Buxhetin.

Buxhetit i planifikuar dhe realizimi i pagave për vitin 2018 (janar/shtator) ishin një ndër çështjet të klasifikuara me prioritet të lartë. Këshilli Drejtues përmes Rektorit duke pasqyruar gjendjen e vështirë financiare në këtë kategori sjell vendim për racionalizim të shpenzimeve për paga dhe mëditje duke propozuar që të rishqyrtohet rregullorja për të ardhura personale për Universitetin e Mitrovicës. Këshilli Drejtues bazuar në përgjegjësitë formoi komisionin i cili do të jetë i obliguar

që të analizoji dhe të propozoi rregulloren e re mbi të ardhura personale. Në këtë kuptim, MASHT-i duke e pasqyruar gjendjen e vështirë financiare për universitete publike, hartoi draftin e parë për unifikim të rregullores për të ardhura personale. Rregullorja është cilësuar si unike duke obliguar të gjitha universitetet publike për zbatim.

Zyra për buxhet dhe financa ishte e obliguar që të hartoj planin e rrjedhës së parasë duke u bazuar në gjendjen aktuale të punësuarve. Prandaj Rektori përmes KD përmes shkresave dhe kërkesave ju është drejtuar faktorëve relevant të vendosjes për alokim të buxhetit shtesë. Mos alokimi/aprovimi i kërkesave për buxhet shtesë për paga do të vështirësonte në masë të madhe funksionalizimi dhe mirëmbajtjen e procesit të mësimdhënës në universitet.

| Nr. | KATEGORIA EKONOMIKE | Paga e planifikuar bazuar në Ligjin mbi ndarjen buxhetore për vitin 2018 | Alokimi e mjeteve për paga për periudhën Janar-shtator/2018 | Pagat e realizuara për periudhën Janar-shtator/2018 | Indeksi i realizimit në raport me mjetet e alokuara për Janar-shtator/2018 |
|-----|---------------------|--|---|---|--|
| | | 2 | 3 | 4 | 5=4/3*100 |
| 1. | PAGA DHE MËDITJE | 2.042.359.00 | 1.765.346.63 | 1.765.346.63 | 100 |

Sipas planit të rrjedhës së parasë për periudhën raportuese është planifikuar (sipas rregullave të MF 1/12 e pagës totale) shuma prej 1.577.207.43 euro janë alokuar 1.765.346.63 euro kurse janë shpenzuar 1.765.346.63 euro dhe janë realizuar mjetet me indeks prej 100% në krahasim me mjetet e alokuara. Bazuar në metodologjinë e aplikuar nga MF,UMIB-i për këtë periudhë është rritur minusi prej 188.079.36 euro në krahasim me mjetet e planifikuara sipas rrjedhës së parasë.


| Nr | Planifikimi I pagave për periudhën janar/shtator të bazuar në planin e rrjedhës së parasë për vitin 2018 | Alokimi I mjeteve për periudhën janar/shtator | Realizimi I pagave për periudhën janar/shtator | minusi I pagës për periudhën janar/shtator |
|----|--|---|--|--|
| | 1 | 2 | 3 | 4=3-1 |
| 1 | 1.577.207.43 | 1.765.346.79 | 1.765.346.79 | (188.139.36) |

Pasqyra e realizimit të pagave të planifikuara, të strukturuar sipas realizimit mujor për UMIB

| n r | UMI B | Pers. Administrativ | shuma | Pers. Akadem. | shuma | Pers. akad/i angazh. | shuma | Tot. | Shuma |
|-----|----------|---------------------|------------|---------------|--------------|----------------------|-----------|------|--------------|
| 1 | JANAR | 47 | 31.242.65 | 100 | 148.027.40 | 45(3) | 2.367.75 | 192 | 181.637.80 |
| 2 | SHKURT | 47 | 30.460.82 | 99 | 160.220.50 | 46(6) | 14.228.55 | 192 | 204.919.50 |
| 3 | MARS | 47 | 30.045.17 | 99 | 155.333.94 | 46(15) | 4.678.00 | 192 | 190.057.11 |
| 4 | PRILL | 47 | 33.322.98 | 98 | 165.200.46 | 49(34) | 13.603.25 | 194 | 212.126.69 |
| 5 | MAJ | 47 | 31.886.18 | 98 | 163.959.12 | 49(37) | 15.679.23 | 193 | 211.524.53 |
| 6 | QERSHOR | 47 | 30.467.37 | 98 | 168.490.40 | 49(37) | 15.876.55 | 193 | 214.834.32 |
| | KORIK | 47 | 30.149.83 | 103 | 148.451.15 | 44(1) | 21.00 | 194 | 178.621.83 |
| | GUSHT | 47 | 30.665.03 | 103 | 163.533.38 | 44(17) | 1807.68 | 194 | 196.006.09 |
| | SHTATOR | 49 | 29.737.66 | 103 | 145.880.74 | 44 | | 196 | 175.618.40. |
| 7 | Gjithsej | | 277.987.69 | | 1.419.097.09 | | 68.262.01 | | 1.765.346.79 |

Nga pasqyra e lartë shënuar vërehen se shuma prej 1.419.097.09 euro është shpërndarë për personelin akademik ose 80.39% të shumës së shpërndarë (1.765.346.79), për personelin akademik të angazhuar janë shpërndarë 68.262.01 euro ose 3.86% dhe për personelin

administrative të strukturuar në administratën qendrore(rektorat) dhe njësitë akademike shuma prej 277.987.69 euro ose 15.74% të shumës së shpërndarë për periudhën raportuese.




Mjetet e realizuara për këtë periudhë janë më të larta për 35.438.45 euro në krahasim me realizimin për periudhën e njëjtë kohore të vitit 2017. Në të njëjtën kohë është zvogëluar minusin paga për 56.494.98 euro në krahasim me 2017.

| nr | periudha e raportimit | paga e realizuar | Minusi në paga |
|----|-----------------------------|------------------|----------------|
| 1 | periudha janar/shtator/2017 | 1.729.848.34 | 244.574.34 |
| 2 | periudha janar/shtator/2018 | 1.765.346.79 | 188.139.00 |

Pasqyra e mungesës së mjeteve e reflektuar sipas muajve.

| NR | MUAJI | Planifikimi i planit të rrjedhës së parasë sipas MF(1/12) e buxhetit të lejuar | Realizimi i pagës të strukturuar sipas muajve | MINUSET E PLANIFIKUARA |
|----|---------|--|---|------------------------|
| 1 | JANAR | 175.245.27 | 181.637.8 | -6.392.53 |
| 2 | SHKURT | 175.245.27 | 204.919.87 | -2.9674.6 |
| 3 | MARS | 175.245.27 | 190.057.11 | -14.811.8 |
| 4 | PRILL | 175.245.27 | 212.126.69 | -36.881.4 |
| 5 | MAJ | 175.245.27 | 211.524.53 | -36.279.3 |
| 6 | QERSHOR | 175.245.27 | 214.834.32 | -39.589.1 |
| 7 | KORIK | 175.245.27 | 178.621.98 | -3.376.71 |
| 8 | GUSHT | 175.245.27 | 196.006.09 | -20.760.8 |
| 9 | SHTATOR | 175.245.27 | 175.618.18 | -373.13 |
| 10 | TOTALI | 1.577.207.43 | 1.765.346.79 | -188.139.00 |




4.2 MALLRA DHE SHËRBIME

Për periudhën janar/shtator bazuar në planin e rrjedhës së parasë janë alokuar mjete në shumë prej 276.286.79 euro, janë realizuar 162.064.68 dhe mjete të zotuar(angazhuara) në shumë prej 21.014.68 euro. Për periudhën raportuese janë angazhuar 183.079.26 ose me indeks të realizimit prej 66.26% më krahasim me mjete e alokuara.

| | KATEGORIA EKONOMIKE | Planifikimi i mjeteve buxhetit sipas | Alokimi i mjeteve | Mjetet e shpenzuara | Mjetet e zotura | Indeksi i realizimit |
|----|---------------------|--------------------------------------|-------------------|---------------------|-----------------|----------------------|
| | | 1 | 2 | 3 | 4 | $5=3/2*100$ |
| 1. | MALLRA DHE SHËRBIME | 316.339.00 | 276.286.79 | 162.064.68 | 21.014.68 | 58.65 |

Mjetet e realizuara për këtë periudhë janë më të ulëta për 17.433.52 ose me indeks prej 17.38 %, në krahasim me realizimin për periudhën e njëjtë kohore të vitit 2017

| nr | periudha e raportimit | shpenzimet e realizuara | Indeksi i realizimit |
|----|-----------------------------|-------------------------|----------------------|
| 1 | periudha janar/shtator/2017 | 179.498.20 | 76.03 |
| 2 | periudha janar/shtator/2018 | 162.064.68 | 58.65 |



Në tabelën e poshtëshënuar janë pasqyruar shpenzimet të strukturuar nëpër kode ekonomike duke bërë krahasime me mjetet e planifikuara sipas ndarjes buxhetore, alokimin e mjeteve dhe realizimin për periudhën raportuese.

| KODI EKONOMIK | KATEGORIA EKONOMIKE | BUXHETI PËR VITIN 2018 | ALOKIMI 1-9/2018 | MJETET E SHPENZUARA 1-9/2018 |
|---------------|---|------------------------|-------------------|------------------------------|
| | | 1 | 2 | 3 |
| 013000 | Mallrat dhe shërbimet | 316,339.00 | 276.286.79 | 162.064.68 |
| 013100 | Shpenzimet e udhëtimit | 5,000.00 | 5,000.00 | 4.988.22 |
| 013130 | Shpenzimet e udhëtimit brenda vendit | | | |
| 013140 | Shpenzimet e udhëtimit jashtë vendit | 2,000.00 | 2,000.00 | 4.328.22 |
| 013142 | Akomodimi gjate udhetimit zyrtar jasht vendit | 2,000.00 | 3,000.00 | 660.00 |
| 013300 | Shërbimet e telekomunikimit | 31,739.00 | 25.154.26 | 11.697.90 |
| 013310 | Shpenzimet per Internet | 5,000.00 | 3.906.21 | 127.90 |
| 013320 | Shpenzime tjera telefonike - Vala 900 | 21,600.00 | 16.200.00 | 10.620.00 |
| 013330 | Shenzimet postare | 500.00 | 409.05 | |
| 013340 | Shpenzimet për përdorim të kabllit optik | 4,639.00 | 4,639.00 | 950.00 |
| 013400 | Shpenzimet për shërbimet | 38,500.00 | 38.500.00 | 19.702.90 |
| 013410 | Shërbimet e arsimit dhe trajnimit | 5,000.00 | 5.000.00 | 2.785.00 |
| 013440 | Shërbimet e përfaqësimit dhe avokaturës | | | |
| 013430 | Shërbime të ndryshme shëndetësore | | | |
| 013440 | Shërbime të ndryshme intelektuale dhe këshillëdhënëse | 1,000.00 | 1,000.00 | |
| 013450 | Sherbime shtypje-jo marketing | 5,000.00 | 5,000.00 | 1.760.00 |
| 013460 | Sherbime tjera kontraktuese | 25,000.00 | 25,000.00 | 14.947.90 |
| 013470 | Sherbimet teknike | 2,500.00 | 2.500.00 | |
| 013480 | Shpenzimet për anëtarësim | | | 210.00 |
| 013495 | Pagesa për Vendime Gjyqësore | | | |
| 013500 | Blerja e mobilieve dhe pajisjeve më pak se 1000 Euro | 20,000.00 | 20,000.00 | 8.525.00 |
| 013501 | Mobilje | | | |
| 013502 | Telefona | | | |
| 013503 | Kompjuterë | | | |
| 013504 | Harduer për teknologji informative | | | |
| 013505 | Makina fotokopjuese | | | |

| | | | | |
|---------------|--|------------------|------------------|------------------|
| 013506 | Pajisje speciale mjekësore | | | |
| 013507 | Pajisje të shërbimit policor | | | |
| 013508 | Pajisje trafiku | | | |
| 013509 | Pajisje tjera | 20,000.00 | 20,000.00 | 8.525.00 |
| 013600 | Blerje tjera të mallrave dhe shërbimeve | 13,500.00 | 13,500.00 | 7.529.76 |
| 013610 | Furnizime për zyrë | 5,000.00 | 5,000.00 | 4.531.76 |
| 013620 | Furnizim me ushqim dhe pije (spitale, burgje, cerdhe- jo dreka zyrtare) | 2,000.00 | 2,000.00 | 1.711.00 |
| 013630 | Furnizime mjekësore (organizata shëndetësore, qendrat e mjekësisë familjare) | | | |
| 013640 | Furnizime pastrimi | 500.00 | 500.00 | |
| 013650 | Furnizim me veshmbathje | 1,000.00 | | 930.00 |
| 013660 | Akomodimi (Strehimi I punëtorëve) | 1,000.00 | 1,000.00 | 357.00 |
| 013670 | Municion dhe armë zjarri | | | |
| 013655 | Furnizim me preparate kimike | 4,000.00 | 5,000.00 | |
| 013681 | Bllombat | | | |
| 013700 | Derivatet dhe lëndët djegëse | 24,000.00 | 23,082.63 | 20,353.65 |
| 013710 | Vaj | | | |
| 013720 | Naftë për ngrohje qendrore | 20,000.00 | 20,000.00 | 17,512.81 |
| 013730 | Vaj për ngrohje | | | |
| 013740 | Mazut | | | |
| 013750 | Qymyr | | | |
| 013760 | Dru | | | |
| 013770 | Derivate për gjenerator | | | |
| 013780 | Karburant për vetura | 4,000.00 | 3,082.63 | 2,840.84 |
| 013800 | Llogarite e avansit | 8,000.00 | 8,000.00 | |
| 013810 | Avans per para te imeta(p.cash) | 2,000.00 | 2,000.00 | |
| 013820 | Avans per udhetime zyrtare | 6,000.00 | 6,000.00 | |
| 01395 | Shërbimet e regjistrimit dhe sigurimeve | 63,600.00 | 50,890.86 | 33,821.59 |
| 013950 | Regjistrimi i automjeteve | | | 1,304.99 |
| 013951 | Regjistrimi dhe sigurimi i automjeteve | 3,000.00 | 1,500.00 | 100.00 |
| 013952 | Taksat komunale e regjistrimit të automjeteve | 600.00 | 300.00 | 355.00 |
| 013953 | Sigurimi i ndërtesave dhe tjera | | | 32,061.60 |

| | | | | |
|---------------|--|------------------|------------------|------------------|
| | | 60,000.00 | 49.090.86 | |
| 014000 | Mirëmbajtja | 93,500.00 | 74.409.04 | 47.151.26 |
| 014010 | Mirëmbajtja dhe riparimi i automjeteve | 2,500.00 | 2.500.00 | 1.628.20 |
| 014020 | Mirëmbajtja e ndërtesave | 80,000.00 | 60.909.04 | 43.220.12 |
| 014040 | Mirëmbajtja e teknologjisë informative | 10,000.00 | 10.000.00 | 320.00 |
| 014050 | Mirëmbajtja e mobilieve dhe pajisjeve | 1,000.00 | 1,000.00 | 1.982.94 |
| 014200 | Shpenzimet e marketingut | 12,000.00 | 12,000.00 | 1.972.00 |
| 014210 | Reklamat dhe konkurset | 2,000.00 | 2,000.00 | 992.00 |
| 014220 | Botimet e publikimeve | 5,000.00 | 5,000.00 | |
| 014230 | Shpenzimet per informim publik | 5,000.00 | 5,000.00 | 980.00 |
| 014300 | Shpenzimet e përfaqësimit | 6,000.00 | 5.250.00 | 5.934.10 |
| 014310 | Drekat zyrtare | 6,000.00 | 5.250.00 | 6.322.40 |
| 014400 | Shpenzime për vendime të gjykatave | 500.00 | 500.00 | |
| 014410 | Shpenzime për vendime të gjykatave | 500.00 | 500.00 | |

Viti fiskal 2018 është sfidues për Universitetin e Mitrovicës por në të njëjtën kohë do të jetë vit i vjeljes së rezultateve për periudhën e funksionimit të universitetit si institucion i posa themeluar i Arsimit të Lartë. Funksionalizimi dhe inaugurimi i Kampusit të ri universitar ngërthen në vetë edhe buxhet shtesë për furnizim : inventar dhe mjete të konkretizimit për kompletim të laboratorëve e në veçanti për mirëmbajtje dhe sigurim të infrastrukturës dhe objekteve përcjellëse. Mbi 80% të mjeteve të planifikuara janë të dedikuara për shërbimet elementare për funksionim të mirëfilltë të aktiviteteve(mirëmbajtje dhe sigurim të objekteve, furnizim me lëndë djegëse,mirëmbajtje të teknologjisë informative-SEMS,furnizim për zyra,shpenzime telefonike-vala dhe shërbime tjera teknike) kurse për pjesën tjetër duhet përcaktuar prioritete: për shërbime kontraktuese(përmbushja e obligimeve për personelin e angazhuar vendor dhe nga jashtë ,shpenzime tjera të paplanifikuara),furnizim me pajisje të imta që janë në funksion të laboratorëve,botime dhe hulumtime shkencore.

Menaxhmenti i UMIB –it planifikoj që në muajin mars/2018 të bëhet inaugurimi i Kampusit të ri universitar. Aktivitetet lidhur me organizimin e inaugurimit janë finalizuar,mirëpo për shkaqe objektive(vonesat në finalizim të ndërtimit të infrastrukturës përcjellëse,inventarit.....)është prolonguar për fund të muajit tetor/2018

Buxheti jo i mjaftuar për këtë kategori do të ndikoj në realizimin e shumë aktiviteteve që bien nën përgjegjësinë e universitetit,mungesë që do të vështirësoj funksionalitetin e objekteve të

ndërtuara. Prandaj ,K.D. përmes rektorit do të bëjë trysni tek faktorët relevant të vendosjes për akordim të buxhetit shtesë për këtë kategori. Prolongimet dhe mos aprovimi i buxhetit shtesë sidomos për inventar,mirëmbajtje dhe sigurim të objekteve do të ndikon në funksionalitetin dhe ofrimin e kushteve për procesin mësimor.

4.3 SHPENZIMET KOMUNALE

Analiza e shpenzimeve komunale për vitin 2017 dhe planifikimi i inaugurimit të kampusit, determinoi edhe kërkesën për buxhet shtesë për vitin 2018. Ministria e Financave aprovoi kërkesën shtesë duke akorduar buxhet shtesë prej 165.000.00 euro. Qëllimi ishte për të mbuluar shpenzimet për ngrohje, energji elektrike dhe shpenzime tjera komunale.

Për këtë kategori janë alokuar mjete në shumë prej 145.614.68 euro duke shpenzuar 38.681.82 euro ose 26.56% të shumës së alokuar. Në realizim të shpenzimeve ndikoi mosrealizimi i inaugurimit të kampusit universitar. Prolongimi i inaugurimit ndikoj edhe në mosrealizim të shpenzimeve të planifikuara.

| Nr. | KATEGORIA EKONOMIKE | Planifikimi sipas buxhetit të aprovuar | Alokimi i mjeteve | Shpenzimet e realizuara | Indeksi i realizimit |
|-----|---------------------|--|-------------------|-------------------------|----------------------|
| | | 1 | 2 | 3 | 4=3/2*100 |
| 1 | SHPENZIME KOMUNALE | 215.000.00 | 145.614.68 | 38.681.82 | 26.56 |

Në tabelën e poshtëshënuar, në mënyrë analitike, janë pasqyruar shpenzimet sipas kodeve ekonomike.

| Nr | Përshkrimi | Planifikimi i shpenzimeve për vitin 2018 | Alokimi i mjeteve | Shpenzimet e realizuara | Indeksi i realizimit |
|----|------------------|--|-------------------|-------------------------|----------------------|
| 1 | 2 | 3 | 4 | 5 | 6=5/4*100 |
| 1. | E. elektrike | 104.000.00 | 84.000.00 | 27.032.00 | 32.18 |
| 2. | H. e ujit | 14.500.00 | 10.433.00 | 3.537.17 | 33.90 |
| 3. | Mbeturina | 10.000.00 | 7.499.68 | 4.872.00 | 64.96 |
| 4. | PTK | 2.500.00 | 2.082.00 | 3.240.65 | 155.50 |
| 5. | Ngrohja qendrore | 84.200.00 | 41.600.00 | | |
| 6 | Totali | 215.200.00 | 145.614.68 | 38.681.82 | 26.56 |

4.4 SUBVENCIONE DHE TRANSFERE

Planifikimi i mjeteve buxhetore për kategorinë e subvencioneve në shumë prej 30.000.00 euro është bërë për t'i stimuluar studentët për lirim nga pagesa, të bazuara sipas rregulloreve për shërbimet e ofruara, si dhe stimulimin e studentëve të dalluar duke i shpërblyer me bursa të ndara nga UMIB-i.

Bazuar në planifikim dhe zotim të mjeteve, Këshilli Drejtues sjellë vendim që të shpallet konkursi për stimulimin e studentëve të dalluar. Shuma e bursave është përcaktuar nga numri i studentëve të cilët i kanë plotësuar kriteret e definuara.

Për periudhën raportuese indeksi i realizimit ë mjeteve të alokuara është 100% .

| Nr. | KATEGORIA EKONOMIKE | Planifikimi sipas buxhetit të aprovuar | Alokimi i mjeteve | Realizimi për janar/shtator/2018 | mbetja | indeksi |
|-----|---------------------------|--|-------------------|----------------------------------|--------|-----------|
| | | 1 | 2 | 3 | 4=2-3 | 5=3:2*100 |
| 1 | SUBVENCIONE DHE TRANSFERE | 30.000.00 | 30.000.00 | 29.999.75 | 0.25 | 100 |

Bazuar në kriteret e përcaktuara dhe shumë e planifikuar janë shpërndarë gjithsej 55 bursa në shumë prej 29.999.75 euro.

4.5 INVESTIMET KAPITALE

Bazuar në Ligjin mbi Ndarjen Buxhetore për këtë vit fiskal, për investime kapitale janë planifikuar mjete në shumë prej 301.500.00 euro që në krahasim me vitin 2017 masa buxhetore është zvogëluar për 298.500.00 ose me indeks prej 50.25% .Mjetet janë planifikuar për furnizim me mjete/pajisje laboratorike për njësitë akademike në shumë prej 241.500.00 euro, 30.000.00 për teknologjinë informative dhe 30.000.00 për ndërtim të infrastrukturës së objekteve.

Për periudhën raportuese mjetet e planifikuara janë alokuar,zotuar dhe sipas planit vjetor të zyrës së prokurimit janë në proces të tenderimit ose të vlerësimit.

Pasqyrë e planifikimit,alokimit,zotimit dhe realizimit të mjeteve për periudhën janar/shtator/2018

| Nr. | KATEGORIA EKONOMIKE | Planifikimi sipas buxhetit | Alokimi i mjeteve | Zotimi i mjeteve | Realizimi për janar/shtator/2018 | Zotimi i mjeteve |
|-----|---------------------|----------------------------|-------------------|------------------|----------------------------------|------------------|
| 1. | | 1 | 2 | 3 | 4 | 5=4:2*100 |
| | Investime kapitale | 301.500.00 | 301.500.00 | 301.500.00 | 85.465.27 | 28.34 |

Në tabelën e poshtëshënuar është pasqyruar gjendja e realizimit të investimeve të planifikuara kapitale.

| nr | Kodi i projektit | Emërtimi i projektit | Shuma e planifik. | Zotimi | Kontratat e lidhura me OP | Realizimi | Mbetja | komente |
|----|------------------|---|------------------------------------|---------------------------|---------------------------|--------------|---------------|---|
| 1 | 1 | 2 | 3 | 4 | 5 | 6 | 7 | 8 |
| 2 | 14040 | Ndërtimi i infrastrukturës në UMIB a.ndricimi i parkut b.ndërtimi i infrastrukturës në park | 30.000.00 6.024.27 23.975.73 | 6.024.27 23.975.73 | 6.024.27 23.975.23 | 6.024.27 | 23.975.23 | Shuma prej 23.975.73 është planifikuar për finalizimin e punëve në ndërtimin e parkut të kampusit |
| 3. | 15258 | Furnizim me pajisje për F.I.M.K. | 100.000.00 | 100.000.00 | 97.489.00 | | | Në realizim |
| 4. | 15259 | Furnizimi me pajisje për FTU | 81.500.00 | 81.500.00 | 50.546.46 | | 30.953.54 | Për shkak të ankesave të O.E. lënda është në shqyrtim tek OSHP |
| 5. | 15260 | Furnizimi me pajisje për FGJ | 60.000.00 | 60.000.00 | 50.295.00 | 50.295.00 | 9.705.00 | Shuma e mbetur do të planifikohet për projekt të ri |
| 6. | 15261 | Furnizimi me pajisje të T.I. | 30.000.00 | 30.000.00 | 29.146.00 | 29.146.00 | 854.00 | Është realizuar |
| 7. | Gjith. | | 301.500.00 | 301.500.00 | 232.105.73 | 85.465.27 | 65.487.77 | |

5. TË HYRAT VETANAKE

Bazuar në përgjegjësitë dhe kompetencat e dala nga Ligji mbi Arsimin e Lartë të Republikës së Kosovës, Statutit të Përkohshëm të Universitetit të Mitrovicës dhe udhëzimit administrativ të MASHT-it nr. 17/2014 për përcaktim të lartësisë së tarifave për ofrim të shërbimeve për studentë, për periudhën raportuese janë inkasuar 50.006.50 euro (niveli Bachelor dhe Master) dhe janë të dedikuar vetëm për mbulimin e obligimeve për kategorinë paga dhe mëditje. Indeksi i realizimit të grumbullimit të hyrave nga shërbimet e ofruara është 47.45% në krahasim me mjetet e planifikuara prej 114.661.00 euro.

Në tabelën e poshtëshënuar janë pasqyruar të hyrat vetanake të planifikuara, inkasimi, alokimi, dhe shpenzimet.

| | Planifikimi sipas Ligjit mbi Buxhetin për 2018 | Të hyrat e bartuara nga viti fiskal 2017 | Inkasimi i THV për janar/shtator | Alokimi i të hyrave vetanake(2017+2018) | Indeksi i realizimit |
|----------|--|--|----------------------------------|---|----------------------|
| | 1 | 2 | 3 | 4=2+3 | 5=3:1*100 |
| 1 | 114.661.00 | 49.510.50 | 54.409.00 | 103.919.50 | 47.45 |

Realizimi i inkasimit të të hyrave vetanake në krahasim më të njëjtën periudhë të vitit fiskal 2017 është më i ulët për 10.033.00 euro .Nga të hyrat e realizuar është planifikuar që të bëhet përmbushja e obligimeve për kategorinë ekonomike paga dhe mëditje.

Për këtë periudhën mjete e alokuara janë në shumë prej 103.919.50 euro nga të cilat nuk kemi mjete të shpenzuara.

Bazuar në zbatimin e vendimit për lirim të studenteve nga shërbimet e ofruara gjatë regjistrimit është bërë kthimi i mjeteve në shumë prej 6.132.50 euro

Planifikohej që në fund të vitit fiskal të bëhet realizimi i të hyrave vetanake të grumbulluara gjatë 2018 për përmbushjen e obligimeve për paga dhe mëditje.

Të Hyrat e realizuara të strukturuar sipas njësive akademike

| Nr | Përshkrimi i të hyrave-pagesave | F A K U L T E T I / N J Ě S I A A K A D E M I K E | | | | | | TOTALI |
|----|--|---|-----------|----------|----------|----------|----------|-----------|
| | | FIMK | FTU | FGJ | EDUKIM | JURIDIK | EKONOMIK | |
| 1 | Për certifikatë të notave dhe diplomës | 480.00 | 250.00 | 182.50 | 487.50 | 120.00 | 220.00 | 1.740.00 |
| 2 | Për diplomë dhe mbrojtje të diplomës | 695.00 | 1.030.00 | 1.310.00 | 25.00 | 20.00 | 115.00 | 3.195.00 |
| 3 | Për paraqitje të provimeve/master | 745.00 | 1.277.50 | 987.50 | | | | 3.010.00 |
| 4. | Për provim pranues për regjistrim për studime master | | | 5.00 | | | | 5.00 |
| 4 | Për provim pranues/plotësues | 890.00 | 472.50 | 142.50 | 2.310.00 | 587.50 | | 4.402.50 |
| 5 | Për provim në rast të transferit | 1.00 | 30.50 | 50.00 | | | | 81.50 |
| 6 | Për semestër për studentë të rregullt | 9.975.00 | 4.750.00 | 2.750.00 | 5.000.00 | 4.200.00 | 4.650.00 | 31.325.00 |
| 7 | Për semestër për studime master | 1.950.00 | 5.550.00 | 3.150.00 | | | | 10.650.00 |
| 8 | Gjithsej | 14.736.00 | 13.360.50 | 8.577.50 | 7.822.50 | 4.927.50 | 4.985.00 | 54.409.00 |